



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 146 prot.

Kamëz, më 5. 11. 2024

V E N D I M
Nr. 108 .Datë 5/11 2024
M B I

“PËRDITËSIMIN E PJESSHËM TË LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE SHTETËRORE TË TRANSFERUARA NË PRONËSI APO PËRDORIM TË BASHKISË KAMËZ SIPAS VKM-SË NR.775, DATË 05.09.2013 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI APO PËRDORIM TË BASHKISË KAMËZ, TË QARKUT TË TIRANËS” SI DHE PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË KAMËZ TË PASURIVE NR.90/4, ZK.1066 DHE 119/3, ZK.1066”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 05.11.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.80 Datë 21.10.2024 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.8743, datë 22.01.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, nenit 3 të ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, të VKM-së nr.28, datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, të VKM-së nr. 775, datë 05.09.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave publike të paluajtshme shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz, Qarku Tiranë”, VKM-së nr. 454, datë 22.06.2011 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Paskuqan , të Qarkut Tiranë” dhe Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr.351, datë 06.06.2023 “Mbi ngritjen e Grupit të Punës për verifikimin, saktësimin, inventarizimin dhe plotësimin e pronave shtetërore të transferuara në pronësi të Bashkisë Kamëz si dhe të pronave që nuk janë transferuar me VKM”; **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për propozim, për përditësimin e pjesshëm të listës së inventarit të pronave shtetërore të transferuara në pronësi apo përdorim të bashkisë Kamëz sipas VKM-së nr.775, datë 05.09.2013, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave që transferohen në pronësi apo përdorim të Bashkisë Kamëz , të Qarkut të Tiranës “ si dhe për transferimin në Pronësi të Bashkisë Kamëz të pasurive nr 90/4, zk 1066 sipas formularëve të përditësimit dhe planeve të rilevimit, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, drejtuar organeve kompetente.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

2. Pas miratimit të vendimit, ndjek zbatimin e tij Drejtoria e Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave dhe Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

